KËRKESË PËR RISHIKIM TË PAKETËS FISKALE 2027

Për paga dinjitoze dhe mbrojtjen e fuqisë blerëse të familjeve, në frymën e standardeve social-ekonomike evropiane

Drejtuar:
Z. Edi Rama, Kryeministër i Republikës së Shqipërisë
Z. Petrit Malaj, Ministër i Financave

Kuvendit të Republikës së Shqipërisë
Z. Niko Peleshi, Kryetar i Kuvendit të Shqipërisë

Në vëmendje
Znj. Milva Ekonomi, Kryetare e Komisionit për Ekonominë, Punësimin dhe Financat, dhe anëtarëve të Komisionit
Të gjithë deputetëve të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë

Për dijeni:
Sh.S. Znj. Sofia Moreira de Sousa, Ambasadore e Bashkimit Evropian dhe Shefe e Delegacionit të Bashkimit Evropian në Republikën e Shqipërisë.

Të nderuar përfaqësues të Qeverisë dhe të Kuvendit,

Ne, organizatat e biznesit, sindikatat dhe organizatat e shoqërisë civile nënshkruese të kësaj letre, ju kërkojmë që në kuadër të Paketës Fiskale 2027 të mbroni pagën minimale nga tatimi mbi të ardhurat, të lehtësoni tatimin mbi pagat e ulëta dhe të vlerësoni ndikimin e kombinuar të ndryshimeve fiskale në çmimet që paguajnë familjet shqiptare.

Për një familje, rezultati real i paketës fiskale matet me sa para merr në dorë në fund të muajit dhe sa i kushton të mbulojë shpenzimet bazë të jetesës.

Këto kërkesa mbështeten në nenin 49, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, që njeh të drejtën e të punësuarve për mbrojtje shoqërore të punës, dhe në nenin 59, pika 1, shkronja "a", që përcakton punësimin në kushte të përshtatshme si objektiv social të shtetit.

Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, ku Shqipëria është palë, njeh në nenin 7 të drejtën për shpërblim të drejtë, pagë të barabartë për punë me vlerë të barabartë dhe kushte jetese dinjitoze për punëmarrësit dhe familjet e tyre. Neni 11 njeh të drejtën për një standard të përshtatshëm jetese, përfshirë ushqimin, veshjen dhe strehimin. Në këtë kuadër, kërkojmë që ndikimi i masave fiskale të vlerësohet mbi bazën e pagës neto dhe të kostos së përballimit të nevojave bazë.

Tatimi mbi pagën dhe të ardhurat që mbeten në familje

Sipas formulës aktuale, të cilën projektligji e ruan për pagat e ulëta, një punëmarrës me pagë bruto prej 50 000 lekësh merr 44 400 lekë në dorë pas kontributeve. Me një pagë bruto prej 51 000 lekësh, zbritja personale bie nga 50 000 në 35 000 lekë, tatimi bëhet 2 080 lekë dhe paga neto zbret në 43 208 lekë.

Kështu, një rritje prej 1 000 lekësh në pagën bruto i lë punëmarrësit 1 192 lekë më pak në muaj.

Kjo situatë krijon një paradoks të papranueshëm: punëmarrësi që përfiton një rritje të vogël të pagës bruto, në vend që të marrë më shumë të ardhura, përfundon duke marrë më pak.

Nëse paga minimale zyrtare rritet dhe pragu i patatueshëm mbetet në 50 000 lekë, edhe punëmarrësit me pagë minimale mund të fillojnë të paguajnë tatim mbi pagën.

Ndryshimi i fashave i propozuar në projektligj jep lehtësim për pjesën e pagës bruto mbi 200 000 lekë në muaj. Për një pagë prej 100 000 lekësh, tatimi mujor mbetet 9 100 lekë. Për një pagë prej 300 000 lekësh, tatimi ulet me 10 000 lekë në muaj.
Kërkojmë që Ministria e Financave të paraqesë edhe alternativa që u japin përparësi punëmarrësve me paga të ulëta dhe të mesme, për të cilët edhe një ndryshim i vogël në pagën neto ndikon drejtpërdrejt në përballimin e shpenzimeve mujore.

Çmimet e ushqimeve bazë dhe efekti i kombinuar i paketës

Ulja e propozuar e TVSH-së nga 20% në 6% për produktet e përcaktuara të shportës bazë mund të sjellë kursime për familjet, nëse ulja pasqyrohet realisht në çmimin e shitjes dhe ruhet me kalimin e kohës.
Shqetësimi ynë është se ulja e çmimeve mund të jetë e pjesshme ose të zgjasë vetëm gjatë muajve të parë.

Edhe me TVSH 6% në faturë, një produkt mund t'i kushtojë konsumatorit më shumë pas gjashtë muajsh sesa përpara ndryshimit, nëse ndërkohë rritet mjaftueshëm çmimi i tij pa TVSH.

Për këtë arsye, duhen vlerësuar së bashku rritja e propozuar e normës standarde të TVSH-së nga 20% në 21%, ulja e pragut të regjistrimit në TVSH nga 10 milionë në 5 milionë lekë xhiro vjetore dhe rritja e propozuar e tatimit mbi dividendin nga 8% në 15%.

Tatimi mbi dividendin zbatohet kur shpërndahet fitimi. Nëse bizneset përpiqen të ruajnë të njëjtin kthim për pronarët duke rritur çmimet, një pjesë e efektit mund t'i kalojë konsumatorit.
Ministria e Financave duhet të shqyrtojë nëse dhe në çfarë mase këto ndryshime mund të pasqyrohen në çmime përgjatë gjithë zinxhirit të furnizimit, nga prodhuesi te magazinat dhe distributorët, deri te shitësi me pakicë.

Familjet me të ardhura të ulëta, familjet që mbështeten në një pagë të vetme dhe pensionistët me të ardhura të kufizuara kanë më pak mundësi të përballojnë rritjen e çmimeve të ushqimit, energjisë, transportit dhe shërbimeve të përditshme.

Për të kuptuar sa e ekspozuar është secila kategori, kërkojmë që analiza të përfshijë edhe një skenar ku çmimet e disa produkteve ose shërbimeve rriten me 15–20% dhe të tregojë sa do t'i kushtonte kjo një familjeje gjatë muajit.

Kërkesat tona

- **Garantimi i patatueshmërisë së pagës minimale.** Të garantohet që paga minimale të mbetet e patatueshme. Pragu i patatueshëm të lidhet me pagën minimale zyrtare dhe të përditësohet automatikisht sa herë që ajo rritet.
- **Rishikimi i mënyrës së llogaritjes së tatimit mbi pagat e ulëta.** Pjesa e pagës deri në pragun e patatueshëm të mbetet e përjashtuar edhe kur paga bruto e kalon këtë prag. Tatimi të zbatohet vetëm mbi pjesën që e tejkalon atë, në mënyrë që çdo rritje e pagës bruto të sjellë edhe rritje të pagës që punëmarrësi merr në dorë.

- **Publikimi i një vlerësimi të ndikimit të kombinuar të masave fiskale.**Vlerësimi të tregojë efektin mbi pagat neto, shpenzimet mujore të familjeve sipas nivelit të të ardhurave dhe kostot e bizneseve të vogla që hyjnë në skemën e TVSH-së.
- **Transparencë dhe monitorim i çmimeve të produkteve me TVSH 6%.** Të publikohet lista e plotë e produkteve me TVSH 6% dhe të monitorohen çmimet e tyre. Çmimet e të njëjtave produkte të krahasohen me nivelin përpara ndryshimit, me raportim publik mujor gjatë gjashtë muajve të parë dhe me një vlerësim të posaçëm pas tre dhe gjashtë muajsh.
- **Zhvillimi i një seance dëgjimore me grupet e interesit.** Të zhvillohet një seancë dëgjimore me përfaqësues të punëmarrësve, konsumatorëve, bizneseve të vogla dhe organizatave të shoqërisë civile. Komisioni përgjegjës të pasqyrojë në raportin e tij propozimet e paraqitura dhe mënyrën se si janë trajtuar.
- **Marrja në konsideratë e standardeve evropiane për pagën minimale.** Gjatë hartimit dhe rishikimit të politikave të ardhshme të pagave, të merret në konsideratë Direktiva (BE) 2022/2041 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit për pagat minimale të mjaftueshme në Bashkimin Evropian dhe të integrohen në politikat kombëtare standardet përkatëse të saj, duke pasur parasysh vendimin e Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian të 11 nëntorit 2025 në çështjen C-19/23. Qëllimi është të garantohet një shpërblim i drejtë që mbulon kostot bazë të jetesës dhe respekton dinjitetin e punëmarrësve.

I kërkojmë Qeverisë dhe Kuvendit të shpjegojnë publikisht sa nga rritja e pagës u mbetet realisht punëmarrësve dhe sa nga ulja e TVSH-së arrin te konsumatori përmes çmimit në dyqan.
Këto dy rezultate duhet të udhëheqin vendimet për mbrojtjen e fuqisë blerëse të familjeve shqiptare.
Ne besojmë se një politikë fiskale e drejtë duhet të mbrojë njëkohësisht të ardhurat e punëmarrësve, konsumatorët dhe qëndrueshmërinë e aktivitetit ekonomik.

Për këtë arsye, kërkojmë që shqetësimet dhe propozimet e paraqitura në këtë letër të merren në konsideratë dhe të trajtohen përmes një dialogu institucional me organizatat nënshkruese.

Me respekt,
ORGANIZATAT NËNSHKRUESE

- Shoqata ProEksport Albania (ProEksport Albania përfaqëson interesat e një industrie me rreth 700 biznese dhe mbi 50.000 të punësuar në Shqipëri)
- Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë
- Konfederata e Sindikatave Shqiptare
- Sindikata e Bashkuar e Arsimit Shqiptar
- Olof Plame International Center
- Qendra “ Aleanca Gjinore për Zhvillim”
- Shoqata “Së bashku ne mundemi”
- Lëvizja Europiane
- Sindikata e Bashkuar e Arsimit Shqiptar,SBASH
- Sindikata e Gazetarëve dhe Punonjësve të Medias (SGPM)
- Unioni i Sindikatave të Shqipërisë (USSh)
- Qëndra për të Drejtat në Punë (CLR)
- Levizja Rinore Egjiptiane
- Sindikata e punonjësve të Policisë së Shtetit
- Sindikata e Gardës së Republikës së Shqipërisës

- GLV Integrimi
- Instituti i Kultures Rome ne Shqiperi - IRCA
- Qendra Shkencë dhe Inovacion për Zhvillim (SCiDEV)
- Qendra për Drejtësi Gjinore në Shqipëri
- Civil Rights Defenders, dega Shqipëri
- Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH)
- Shoqata Kristiane e Grave Shqiptare
- Qendra TREJA
- Rrjeti i Informimit dhe Qytetarisë Aktive INAC
- Qendra Kombëtare për Shërbime Komunitare (NCCS)
- Qendra " Të Ndryshëm & Të Barabartë (D&E)
- Qendra ALTRI
- Qendra për Zhvillim Komunitar "Sot për të Ardhmen"
- Organizata: "Vish këpucët e mia"